

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Gani Avdiu Kryesues, Mediha Jusufi dhe Ramë Hyseni, - anëtarë, (më tej kolegji) në kontestin e paditësit M.P. nga ..., i përfaqësuar nga H.K., av. në Glllogoc, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “INSIG” në Prishtinë e përfaqësuar nga A.K., për kompensimin e dëmit material dhe jo material, duke vendosur sipas ankesave të palëve, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Glllogoc, C.nr.61/11 të dt. 02.05.2014, në seancën e kolegjit, të mbajtur me dt. 08.03.2017, jep:

A K T G J Y K I M

Pjesërisht aprovohet ankesa e përfaqësuesit të paditësit av. H.K. ashtu që **Ndryshohet** paragrafi I. i aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Glllogoc, C.nr.61/11 i dt. 02.05.2014, dhe gjykohet si vijon:

Detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “INSIG” në Prishtinë, që paditësit M.P., nga ..., në emër të kompensimit të dëmit jo pasuror: të shkaktuar si pasojë e aksidentit në komunikacion të dt. 27.11.2010, në rrugën Magjistrale Prishtinë-Pejë, në vendin e quajtur te “Kroni i Mretit” t’i paguaj shumën prej: për dhembje fizike shumën prej 3.500 euro, për dhembje shpirtërore për zvogëlim të aktivitetit jetësor në shkallën prej 40%, shumën prej 12.000.00 euro, me kamatë vonesë si për mjetet e depozituara në kursim mbi një vit të bankat pa destinim të caktuar, e cila rrjedh nga data 02.05.2014, si ditë e vendimmarrjes në gjykatën e shkallës së parë deri në pagesën definitive të borxhit.

Refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia e paditësit për dëmin jo material, përtej shumës së gjykuar, si dhe kamatë vonesa mbi këtë shumë.

Paragrafi I. i aktgjykimit ankimor që ka të bëjë me shumat e gjykuara për kompensimin e dëmit material **Vërtetohet** ndërsa ankesat refuzohen si të pa themelta.

Refuzohet ankesa e përfaqësuesit të paditësit av. H.K. dhe vërtetohet par.2 i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë për vendimin që ka të bëjë më rentën, me përjashtim të vendimit për kamatëvonesën i cili ndryshohet dhe gjykohet me kamatëvonesë si për mjetet e depozituara mbi një vit me kursim të bankat, pa destinim të caktuar e cila rrjedh nga dt. 02.05.2014 si ditë e dhënies së aktgjykimit nga gjykata e shkallës së parë e deri në pagesën definitive të borxhit.

Paragrafët 3 e 4 të dispozitivit aktgjykimit të shkallës së parë që ka të bëjë me pjesën refuzuese të kërkesëpadisë së paditësit kundër të paditurës, si dhe me vendimin për shpenzimet mbeten të pa ndryshuar.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Glllogoc, me aktgjykimin C.nr.61/11 të dt. 02.05.2014, ka vendosur si vijon:

“I. Pjesërisht aprovohet e bazuar kërkesëpadia e paditësit M.P. nga ... dhe Detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “INSIG” në Prishtinë, që paditësit në emër të kompensimit për dëmet e shkaktuara në aksident të komunikacionit të ndodhur me dt. 27.11.2010, e në magjistralen Prishtinë-Pejë, në vendin e quajtur te “Kroni i Mretit”, i ndodhur me fajin ekskluziv të të siguruarit tek e paditura, paditësit të i kompensoj:

A. Për dëme jo materiale:

- për frikën e përjetuar të të gjitha llojeve e intensiteteve shumë prej 2.500 euro,
- për dhembje fizike të të gjitha intensiteteve shumë prej 3.000 euro,
- për shëmtim trupor të shkallës së mesme shumë prej 3.000 euro,
- për zvogëlim të aktivitetit jetësor në shkallën prej 40% shumë prej 8.000 euro,

B. Për dëme materiale:

- për ushqim të përforcuar shumë prej 150 euro,
- për përkujdesje nga personi i tretë shumë prej 300 euro,
- për rehabilitim klimatik për 60 ditë shumë prej 800 euro,
- për shpenzime të shërimit shumë prej 2.500 euro,

E që gjithsejtë A+B kapin shumë prej 18.500 euro, këto me kamatë ligjore sikurse për mjetet e deponuara në banka pa afat kthimi nga dita e vlerësimit të dëmeve e deri në pagesën definitive, pasi që aktgjykimi të marri formën e prerë.

II. Në emër të fitimit të munguar për 15 muaj për humbje të plotë të aftësisë për punë 100% e duke filluar prej dt. 27.11.2010 e deri me 31.03.2014 në emër të rentës e paditura paditësit do ti kompensoj shumë prej 3.373,25 euro, e me kamatë të llogaritur prej ditës së ushtrimit të padisë me dt. 24.03.2011 e deri me 31.03.2014, me normë prej 3,5% në vit shumë prej 472,44 euro, që arrin shumë prej 3.845,61 euro.

Për periudhën e ardhshme prej dt. 01.04.2014 e tutje deri sa për të ekzistojnë kushtet ligjore shumë mujore prej 63,50 euro.

III. Shumat e pa gjykuara:

Për frikën e përjetuar prej 2.000 euro, për dhembje fizike shumë prej 1.500 euro, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumë prej 4.000 euro, për ushqim të përforcuar shumë prej 146 euro, për ndihmë nga personi i tretë shumë prej 300 euro, për

gardërobë shuma prej 100 euro, për rehabilitim shëndetësor shumën prej 500 euro, për shpenzime të shërimit shumën prej 893 euro.

Që gjithsejtë kapin shumën prej 9.439 euro, Refuzohen të pa bazuara.

IV. Në emër të shpenzimeve të procedurës e paditura, paditësit do t'i paguaj shumën prej 1.041 euro me kanosje për ekzekutim me dhunë”.

Kundër aktgjykimit të shkallës së parë, përfaqësuesi i paditësit av. H.K., me dt. 22.05.2014, ka paraqitur një ankesë me të cilën ka kërkuar që aktgjykimi ankimor të ndryshohet në favor të pretendimeve ankimore, duke pohuar se gabimisht është zbatuar e drejta materiale.

Kundër aktgjykimit të shkallës së parë ankesë ka paraqitur edhe përfaqësuesi i të paditurës i autorizuar A.M., me dt. 20.05.2014, me të cilën ka kërkuar që aktgjykimi ankimor të ndryshohet, në favor të pretendimeve ankimore, duke parashtruar këto shkaqe: *Shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.*

Kompetenca: Kolegji, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare, e në bazë të shkresave në dosje përfshirë edhe ankesat, vlerësoi se ka juridiksion për procedim dhe vendimmarrje në këtë çështje juridike, duke u bazuar në nenet: 17 e 19 të Ligjit për gjykatat, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” nr. 79/2010), si dhe neneve 190 e 194 të LPK.

Shqyrtimi i pranueshmërisë së ankesave: Gjykata e shkallës së dytë duhet të shqyrtoj pranueshmërinë e ankesave, në raport me kërkesat ligjore të specifikuara me nenet 176, 178 e 186 të LPK, para se të vendosë për themelësinë e saj.

Me vështrim në shkresa të lëndës (Fletë kthesat për dorëzimin e aktgjykimit të shkallës së parë si dhe zarfi për dorëzimin e ankesës së të paditurës në postë dhe shenjës së vulës së pranimit) rezulton se ankesat janë paraqitur brenda afatit ligjor, ato janë të lejueshme sepse janë paraqitur nga personat e autorizuar dhe që kanë interes juridik, ndërsa paraprakisht nuk kanë hequr dorë nga e drejta në ankim, kurse ankesat e paraqitura nuk janë tërhequr deri në ditën e vendimmarrjes.

Ankesat përmbajnë elementet e përcaktuara me ligj, pra ato janë të plota.

Kolegji, vlerëson se ankesat i përmbushin kërkesat ligjore nga nenet 176,178 lidhur me nenin 186 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 38/08), i datës 20 shtator 2008, i cili ka hyrë në fuqi me 6 tetor 2008 (më tej LPK).

Kufijtë e ekzaminimit të aktgjykimit të shkallës së parë: Gjykata e Apelit në seancën e kolegjit, në bazë të nenit 194, të LPK e ekzaminoj aktgjykimin e shkallës së parë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesa si dhe duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore, dhe gjeti se:

Ankesa e përfaqësuesit të paditësit është pjesërisht e themeltë.

Kolegji, në bazë të gjendjes në shkresa të lëndës, konstaton se në pjesën ndryshuese dhe vërtetuese të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë gjatë zbatimit të procedurës kontestimore, nuk ka bërë shkelje thelbësore, të dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 182 par.2 nën par. b),g),j),k) dhe m) të LPK, për të cilat Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare, e as shkelje tjera procedurale të specifikuar në nenin 197 të LPK.

Nga shkresat në lëndë rezulton se gjykata e shkallës së parë për vërtetimin e gjendjes faktike në seancat për shqyrtimin kryesor të çështjes kishte marrë provat e përshkruara në procesverbalet e seancave gjyqësore për shqyrtimin e çështjes, dhe ka konstatuar gjendjen faktike të përmbajtur në arsyetimin e aktgjykimit ankimor, si vijon:

Se në mes të palëve procedurale nuk është kontestues fakti se me dt. 27.11.2010 në magjistralen Prishtinë-Pejë, në vendin e quajtur te “Kroni i Mretit”, kishte ndodhur një aksident i komunikacionit, si pasojë e të cilit paditësi M.P., kishte pësuar lëndime të rënda trupore si pasojë e të cilave ka përjetuar dhembje fizike, frikë, zvogëlim të aktivitetit jetësor në shkallën prej 40%, si dhe shëmtim të mesëm dhe zvogëlim të aktivitetit të përhershëm punues në shkallën prej 20%. Aksidenti ishte shkaktuar me fajin e të siguarit të paditurës.

Këto forma të dëmit ishin konstatuar nga mjekët kompetent. Fakt kontestues në mes të palëve procedurale ishte vetëm lartësia e kërkesëpadisë për kompensimin e formave të dëmit material dhe jo material.

Në bazë të kësaj gjendje të çështjes, gjykata e shkallës së parë, kishte vlerësuar se janë përmbushur kërkesat ligjore nga nenet 154, 155, 158, 188, 189, 199, 200 e 201 të LMD, për të vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Pretendimet ankimore: Përfaqësuesi i paditësit, në ankesë e paraqitur ka pohuar se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale kur ka caktuar shumat për gjykim për dhembje fizike, në shumë prej 3.000 euro, që do të duhej të ishte 4.500 euro, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, në shkallën prej 40% shumë prej 8.000 euro, që do të duhej të ishte 12.000 euro, për shpenzimet e shërimit, shuma prej 2.500 euro, do të duhej të ishte 3.445.60 euro, si dhe shumat e gjykuara në emër të rentës, duke kërkuar që të caktohet vlera e kapitalizuar në shumë prej 12.434,36 euro, ndërsa në pjesën tjetër aktgjykimi të mbetet i pa ndryshuar.

Kolegji, konstaton se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe plotësisht e ka konstatuar gjendjen faktike sa i përket pjesës vërtetuese dhe ndryshuese të aktgjykimit të shkallës së parë, por për pjesën ndryshuese gabimisht e ka zbatuar të drejtën materiale me ç ‘rast vlerësoi se janë krijuar kushtet ligjore nga neni 201 d) i LPK që aktgjykimi ankimor të ndryshohet.

Shumat e gjykuara me aktgjykimin e shkallës së parë, në emër të dhembjeve fizike në emër të kompensimit të dëmit jo material për zvogëlim të aktivitetit jetësor në shkallën

prej 40%, janë caktuar, duke zbatuar gabimisht të drejtën materiale, kriteret për vlerësim dhe praktikën gjyqësore dhe duhej gjykuar si në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së dytë. Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së dytë, shumat e gjykuara si në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së dytë, në pjesën ndryshuese, janë të bazuara në ligj neni 200 i LMD, si dhe me praktikën gjyqësore dhe se ato përfaqësojnë satisfaksion adekuat që paditësi më lehtë t'i përjeton dhembjet fizike dhe shpirtërore për zvogëlimin e aktivitetit jetësor.

Për Përgjegjësinë në rast të aksidentit të shkaktuar nga automjetet në lëvizje, për faj të vetëm të një poseduesi të automjetit duhet të zbatohen rregullat e përgjegjësisë në bazë të fajësisë, ashtu siç është përcaktuar me nenin 178 par 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve ("Gazeta Zyrtare e ish RSFJ" Nr. 29/78).

Në rastin konkret fajtor i vetëm për shkaktimin e dëmit ishte i siguruari i të paditurës, atëherë vijnë në shprehje rregullat e përgjegjësisë sipas sigurimit të detyrueshëm nga auto përgjegjësia, përkatësisht neni 919 i LMD.

Sa i përket vendimit për kamatëvonesën ai është i bazuar në nenin 277 të LMD, si dhe praktikën gjyqësore të krijuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, me rastin e vendimmarrjes sipas mjeteve të jashtëzakonshme juridike.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore të përfaqësuesit të paditësit lidhur me kërkesën për tu gjykuar vlera e përgjithshme e rentës, ky pretendim ankimor është i pathemeltë pasi që në rastin konkret nuk ka provuar se janë përmbushur kërkesat ligjore të paragrafit 4 të nenit 188 të LMD.

Kjo formë e kompensimit të dëmit,(rentës) nuk ishte goditur me ankesë nga pala e paditur.

Pretendimeve ankimore të përfaqësuesit të paditurës: Përfaqësuesi i të paditurës në ankesë ka pohuar se aktgjykimi ankimor është dhënë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2 n) të LPK, duke pohuar se dispozitivi i aktgjykimit është i paqartë dhe është në disproporcion me arsyetimin, duke mos sqaruar se në çka qëndrojnë shkeljet e pretenduara.

Kolegji, pretendimin ankimor të të paditurës e vlerësoi të pathemeltë, pasi që ai përfaqësonte vetëm një pretendim të përgjithësuar, të pa argumentuar. Aktgjykimi i shkallës së parë kishte një dispozitiv të qartë, jo kontradiktor, i cili nuk ishte në kundërshtim me arsyetimin e tij.

Pretendimet ankimore të përfaqësuesit të paditurës se shumat e gjykuara në emër të kompensimit të dëmit jo material dhe material janë në kundërshtim me natyrën e lëndimit dhe format e dëmit, që paditësi kishte pësuar në rastin aksidental, nuk ishin të argumentuara me fakte të provuara. Nuk është i vetëmjaftueshëm vetëm një pretendim ankimor, por ai duhet të jetë i argumentuar me fakte relevante, që do të ishin me ndikim në vendimmarrjen e pretenduar të palës ankuuese. Andaj, për këtë arsye pretendimet ankimore të paditurës u refuzuan si të pathemelta.

Kolegji e vlerëson të drejt qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë lidhur me kompensimin e dëmit material par.1b) i aktgjykimit ankimor, që përfshin shumat e gjykuara për ushqim të përforcuar, kujdesin nga personi i tretë, rehabilitim si dhe shpenzimet e shërimit pasi që ky vendim ishte dhënë në bazë të vlerësimit të provave në shkresa të lëndës, si dhe bindjes së lirë e duke u bazuar në nenin 323 të LPK.

Më sa u tha më lartë, kolegji vlerëson se janë krijuar kushtet ligjore nga nenet 197 b), 200 e 201 d) të LPK, për të vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-PRISHTINË
CA. nr.2598/2014 dt. 08.03.2017

Kryesuesi i Kolegjit – gjyqtari
Gani Avdiu